

**VENDIM**  
**Nr.743, datë 6.11.2003**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.159, DATË 13.3.2003 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE "PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË  
PRIVATIZOHET, SI DHE PROCEDURA E SHITJES"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë dhe veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në kapitullin III "Procedurat e shitjes së pronës shtetërore" të vendimit nr.159, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 12 shfuqizohet;

2. Fjalja e parë e pikës 13, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Procedurat për rastet e parashikuara në pikat 9, 10 dhe 11 të fillojnë me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**